

MENDIM PAKICE

Ne gjyqtaret Blerona Hasa dhe Marsela Dervishi, parashtrojmë mendimin tonë, në çështjen Nr.2 Akti Dt.24.02.2023, me:

PADITËSE: Partia Bindja Demokratike.

IPADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

OBJEKTI: Anullimin e Vendimit nr.07, datë 25.01.2023 të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve, për shqyrtimin e kërkesës nr.04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, në trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Emona Muçi kryesuese/relatore, me anëtarë Sokol Ibi, Edlira Petri, Marsela Dervishi dhe Blerona Hasa, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendosi me shumicë votash, pushimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e akteve për kompetencë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ne gjyqtaret Blerona Hasa dhe Marsela Dervishi, parashtrojmë mendimin kundër, për shkaqet në vijim.

Sikurse evidentohet edhe në vendimin e shumicës, Partia “Bindja Demokratike” rezulton subjekt politik pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021.

Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezulton të ketë përpiluar dokumentin “Raport i gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

Referuar gjetjeve të evidentuara ne këtë raport, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë investuar me date 14.12.2022, Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, me kërkesë për vendosje sanksioni administrativ, nder te tjera edhe për subjektin politik, Partia “Bindja Demokratike”.

Kërkesa rezulton të jetë bazuar në argumentin e:

- Mosdorëzimit të raporteve për 153 kandidatë të listave shumë-mërore, me pasojë mosauditimin e raporteve të kandidatëve;
- Kryerjes së shpenzimeve për reklama politike në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram, nga 12 kandidatë.

Kërkesa rezulton të ketë referencë, Nenin 173/3 te Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

“Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës...

3. Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh. Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezultoi të ketë disponuar lidhur me kërkesën, Vendimin Nr.07. Dt.25.01.2023, që konsiston në vendosjen e sanksionit administrativ, në masën 500.000 lekë, për subjektin zgjedhor “Bindja Demokratike”.

Lidhur me kërkespadinë e këtij të fundit kundër Vendimit Nr.07. Dt.25.01.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, shumica e trupës së Kolegjit Zgjedhor ka vendosur pushimin e gjykimit dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me argumentin se:

“36. Duke i’u kthyer ankimeve ndaj vendimeve të komisioneve zgjedhore, me përfundimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e ankimeve zgjedhore, subjektet zgjedhore pushojnë së qeni të tilla dhe vijojnë të jenë thjesht parti politike (ato mund të jenë parti politike parlamentare ose jo, në varësi të rezultatit që kanë marrë në zgjedhjet pararendëse). Po ashtu, pas përfundimit të zgjedhjeve, nuk mund të ketë as ankime për refuzim të akreditimit të vëzhguesve, pasi nuk ka një proces zgjedhor (ai ka përfunduar).

37.Për rrjedhojë, me mbylljen e procesit zgjedhor, shpalljen e rezultatit dhe përfundimin e afatit të ankimeve, përfundon edhe procesi i shqyrtimit në rrugë gjyqësore të çështjeve zgjedhore. Veprimtaria e KZGJ-së mundet eventualisht të vijojë edhe pas përfundimit të procesit të ankimimeve, kur shpallet pavlefshmëria e zgjedhjeve dhe ato përsëriten në një apo disa zona zgjedhore (shih nenin 161 të Kodit Zgjedhor). Në këtë rast, do të priten edhe ankimet e mundshme pas përsëritjes së zgjedhjeve.

39. Kompetencat e KZGJ-së jo vetëm që nuk përfshijnë shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me kundërvajtjet e kryera sipas Kodit Zgjedhor, por KZGJ nuk shqyrton as çështje që kanë ndikim në vijimësinë e një mandati të fituar në zgjedhje, siç janë rastet e vendimeve të KQZ-së për pavlefshmërinë e mandatit të të zgjedhurve, që kanë impakt të drejtpërdrejtë në listat e kandidimit, me të cilat një subjekt zgjedhor ka marrë pjesë në zgjedhje. Në një prej rasteve kur është vënë në diskutim çështja e kompetencës lëndore mes gjykatës administrative dhe Kolegjit Zgjedhor, ndërsa gjykata administrative arsyetonte se janë në kompetencë të Kolegjit Zgjedhor të gjitha vendimet e KQZ-së që cenojnë të drejtat e subjekteve zgjedhore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, e gjeti të pabazuar këtë qëndrim (shih vendimin nr.667, datë 08.05.2018 të Gjykatës së Lartë). Ndër të tjera, Kolegji Administrativ arsyeton se:”...Një nga kategoritë e mosmarrëveshjeve administrative që ligjvënësi e ka përjashtuar nga fusha e shqyrtimit të gjykatave administrative janë ato që burojnë nga vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kuadër të procesit zgjedhor. Mbështetur në analizën e bërë më sipër kompetenca lëndore e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë, shtrihet vetëm për mosmarrëveshjet që lindin nga procesi zgjedhor (kundërshtimi i vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me administrimin e procesit zgjedhor). Asnjë mosmarrëveshje tjetër, qoftë edhe kur buron nga vendimmarrja e këtij organi publik (Komisionit Qendror të Zgjedhjeve), por jo në kuadër të procesit zgjedhor, nuk mund t’i atribuohet kompetencës lëndore të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë. Pra, kompetenca e saj, duke qenë ekskluzive, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe fokusohet vetëm në mosmarrëveshjet zgjedhore, të ngritura nga subjektet zgjedhore. ...”.

Bazuar në këto argumenta, rezultoi që shumica të ketë evidentuar, kohën e disponimit të vendimit të kundërshtuar, si element përcaktues në identifikimin e gjykatës kompetente për shqyrtimin e tij.

Pra, sipas argumentave që shumica vë në themel të vendimit të saj, kompetente për shqyrtimin e padisë me objekt kundërshtimin e sanksionit të vendosur ndaj palës paditëse, do të ishte Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, nëse vendimi sanksionues do të ishte disponuar nga KAS, para

përfundimit të zgjedhjeve dhe para se të përfundonin shqyrtimet e ankimeve zgjedhore.

Përkundër vendimit të shumicës vlerësojmë se, nuk është koha përcaktuese, por shkak për të cilin është disponuar vendimi objekt padie.

Në këtë kontekst lipset vërejtur se, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve e ka bazuar vendimin objekt padie, në Nenin 21 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

“Kompetencat e KAS-it

1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS-i ushtron këto kompetenca:

dh) me kërkesë të Komisionerit vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet”.

Në kuptim të përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar, vlerësojmë se, shkak për sanksionimin e paditësit me gjobë, nuk ka qenë mospërmbushja e detyrimeve të tij si subjekt politik, por mospërmbushja e detyrimeve të marra përsipër prej tij si subjekt zgjedhor, në kuptimin që, jo domosdoshmërisht, një subjekt politik është njëherësh edhe subjekt zgjedhor.

Rrjedhimisht, nëse një subjekt politik zgjedh të bëhet pjesë e një procesi zgjedhor, të konvertuarit e tij në subjekt zgjedhor sjell si pasojë lindjen veç te drejtave, edhe të disa detyrimeve të lidhura me procesin zgjedhor, në të cilin ai konfirmohet se ka marrë pjesë, përfshirë këtu detyrimet lidhur me shpenzimet e fushatës zgjedhore.

Kodi Zgjedhor përkufizon në Nenin 2/28 se:

“28. “Shpenzime të fushatës zgjedhore” janë shpenzimet e bëra nga ose në emër të një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët dhe/ose degët e tij, ose të një kandidati të pavarur, të cilat kryhen për të promovuar fushatën e vet ose për të dëmtuar fushatën e një subjekti tjetër, përfshirë kandidatët e tij, pavarësisht datës se kur janë kryer”.

Më tej, detyrimet që lindin në raport me shpenzimet e subjektit zgjedhor, gjatë fushatës zgjedhore, parashikohen në Nenet 3 pika 5/1, 92/3, 92/6 dhe 173 të Kodit Zgjedhor, sipas përmbajtjes respektive të të cilëve:

“5/1 Subjektet zgjedhore përfitojnë financime publike dhe jopublike në mbështetje të fushatës së tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse. Subjektet zgjedhore bartin detyrimin për transparencë dhe publikim të të ardhurave dhe shpenzimeve në zgjedhje kundrejt KQZ-së, personave të ngarkuar me auditimin apo monitorimin dhe publikut”. (Neni 3)

“1. Subjektet zgjedhore janë të detyruara të paraqesin raport financiar për fushatën zgjedhore në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve.

2. Raportet financiare hartohen sipas modeleve të miratuara nga KQZ-ja. Raporti, si rregull, duhet të përmbajë informacion, për:

a) çdo dhurim, hua ose kredi që i është dhënë subjektit zgjedhor (duke përfshirë edhe degët dhe kandidatët e tij) gjatë fushatës zgjedhore dhe gjashtë muaj para fushatës dhe burimin e tij, përfshirë edhe dhurimet apo shërbimet në natyrë;

b) të ardhurat për qëllime të fushatës zgjedhore nga të gjitha burimet e tjera të lejuara;

c) të gjithë zërat e shpenzimeve për qëllime të fushatës zgjedhore siç përcaktohen në vendimin e KQZ-së dhe në pikën 4 të nenit 92/2 të këtij ligji;

ç) bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve.

3. Çdo parti politike që merr pjesë në zgjedhje mban dhe ruan në arkiv për një periudhë prej 7 vjetësh dokumentacionin e plotë dhe të hollësishëm të statusit të saj financiar dhe të degëve të saj për periudhën që mbulon ky raport, duke përfshirë:

a) librat e llogarive/kontabilitetit, mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku pasqyrohen të gjitha të ardhurat sipas burimit dhe shumës, identifikohet si është bërë pagesa, si dhe pagesat e bëra personave të tretë, qëllimet e pagesave dhe se si është kryer çdo pagesë;

b) dokumentacionin e të gjitha shpenzimeve të bëra;

c) situatën dhe lëvizjet në llogarinë e saj bankare;

ç) dokumentacionin e plotë të pronave të paluajtshme që zotëron partia politike, si dhe çdo kontratë të lidhur për marrje me qira, dhënie me qira, porositje apo shitje të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme;

d) regjistrin e dhuruesve, huadhënësve dhe kredihënësve, sipas modelit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 92/2”. (Neni 92/3)

“1. Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar, të përzgjedhur sipas nenit 92/7 të këtij ligji, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore. Raporti i auditimit paraqitet në KQZ brenda afatit të përcaktuar në vendimin e emërimit. Raporti nuk mund të përfshijë të dhëna personale të dhuruesve nën vlerën e parashikuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 92/2 të këtij ligji.

2. Subjektet zgjedhore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokument apo të dhënë, që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas këtij ligji.

3. Subjektet zgjedhore që auditohen duhet të vënë në dispozicion çdo informacion që disponojnë nga bankat, institucione apo persona të tretë që kanë lidhje me auditimin ose të autorizojnë auditin për tërheqjen e tyre nga të tretët. KQZ-ja vë në dispozicion të auditit në çdo fazë të auditimit informacionet që i paraqiten nga të tretët për objektin e auditimit.

4. KQZ-ja publikon raportet e auditimit për subjektet zgjedhore jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga data e mbylljes së verifikimeve përkatëse.

5. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në këtë kre nga subjektet zgjedhore apo dhuruesit, në rast se nuk përbën vepër penale, është kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas parashikimeve të Pjesës XIII të këtij ligji.

6. KQZ-ja ka të drejtën të verifikojë drejtpërdrejt të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, raportin e auditimit sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe çdo informacion tjetër për lëndën për të cilin vihet në dijeni. KQZ-ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t’i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohet administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji”. (Neni 92/6)

dhe

“Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës...

3. Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh. Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë”. (Neni 173, Pjesa XIII)

Pala paditëse, sikurse evidenton edhe shumica në vendimin e saj, konfirmohet të ketë qenë subjekt zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25.04.2021 dhe të ketë zhvilluar për këtë shkak, fushatën e saj.

Ky fakt vlerësojmë se përbën rrethanë të mjaftueshme për sanksionimin e saj me gjobë, nëse nuk përmbush detyrimet që i lindnin nga ky proces, pavarësisht nga koha kur merret vendimi për sanksionim.

Në vlerësimin tonë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ishte kompetent për shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit Nr.07 Dt.25.01.2023 të KAS, përsa kohë konfirmohet se:

- Paditësi ka qenë subjekt zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvendin, të datës 25.04.2021;
- Vendosja e gjobës në masën 500.000 lekë, përbën sanksion që lidhet me financimin e fushatës së tij, në këtë proces zgjedhor, të administruar nga KQZ.

Për sa më sipër, nuk bashkohemi me përfundimin e shumicës se:

“...në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, që kufizojnë kompetencën e KZGJ-së vetëm në shqyrtimin e ankimeve, lidhur me procesin zgjedhor, arrihet në përfundimin se çdo mosmarrëveshje tjetër e KQZ-së, që nuk lidhet me këtë proces, por me ushtrimin e funksioneve publike të ngarkuara me këtë Kod dhe me ligje të tjera të vecanta, nuk bëjnë pjesë në fushën e kompetencës së kësaj gjykate, por duhet të ankimohen në rrugën e zakonshme në gjykatën administrative”.

Përfundimet e mësipërme i bazojmë pikërisht në Vendimin Nr.667 Dt.08.05.2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ku referon edhe shumica, por në të cilin, veç argumentave të evidentuara nga kjo e fundit, rezulton që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të ketë evidentuar dhe konkluduar gjithashtu se:

“Nga parashtrimi i rrethanave të faktit që kanë bërë të dyja gjykatat në mosmarrëveshje ka rezultuar se në çështjen në shqyrtim është ngritur një padi nga deputeti Aqif Rakipi, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka vendosur ndërprerën e parakohshme të mandatit të deputetit, në bazë të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”...

Duke u rikthyer në çështjen në shqyrtim vërehet se mosmarrëveshja konkrete nuk buron nga procesi zgjedhor por nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në kuadër të një reforme të pjesshme kushtetuese, me qëllim pastrimin e organeve shtetërore, dhe kryesisht atyre të larta të pushtetit, nga individët me një të shkuar kriminale, duke pasur si objektiv përfundimtar forcimin e besimit të publikut në këto organe.

Edhe pse, mbështetur në përmbajtjen e këtij ligji (neni 10), kompetencat vendimmarrëse në lidhje me mandatin e deputetëve të Kuvendit që preken nga zbatimi i tij, i janë dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ky i fundit, në këtë rast, nuk vepron si organ i administrimit të procesit zgjedhor. Në të njëjtën kohë argumenti i mësipërm përforcohet edhe nga fakti se subjekti që ka

inicuuar një proces të tillë nuk konsiderohet si subjekt zgjedhor. Subjekte zgjedhorë, sipas nenit 2/20 të Kodit Zgjedhor janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”.

Për sa më sipër vlerësojmë se, në vend të disponimit për pushim gjykimi, kërkespacia do të duhej të shqyrtohej në themel dhe të vendosej rrëzimi i saj, duke konfirmuar në këtë kontekst, përfundimet korrekte të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, se:

“2.Palët e interesuara pjesëmarrëse në seancë ngritën dy pretendime kryesore për të justifikuar shkeljet e konstatuara, pretendimin se mungesa e raportimeve për kandidatët vjen për shkak se kandidatët nuk kanë pasur shpenzime (në rastin e partisë politike “Nisma Thurja”, për shkak se nuk kanë kryer fushatë), si dhe pretendimin se për partitë pjesëmarrëse në koalicion nuk mund të vendosen sanksione administrative, sa kohë që detyrimi për raportim i takon partisë udhëheqëse të koalicionit.

12.Për këto arsye, KAS-i e gjen me vend që t’u rrëzojë pretendimin e paraqitur për mosraportim të kandidatëve “për shkak se nuk kanë pasur shpenzime, ngaqë nuk kanë bërë fushatë”. Kandidimi fiktiv është në kundërshtim të hapur me qëllimin e zgjedhjeve dhe parimet mbi të cilat zhvillohen ato, prandaj KAS-i nuk mund ta legjitimojë këtë praktikë.

17.Qëllimi i paragrafit 3 të nenit 65 të Kodit Zgjedhor nuk është përcaktimi i një pozite të privilegjuar të partisë udhëheqëse të koalicionit në raport me partitë pjesëmarrëse të tij. Fjalja “për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit” ka qëllim vetëm të përcaktojë partinë udhëheqëse të koalicionit si pikë kontakti dhe interlokutor të KQZ-së, në emër dhe për llogari të koalicionit. Nuk është qëllim i Kodit dhe nuk ka kuptim që të pretendohet se themelimi i koalicionit “asgjëson” partitë pjesëmarrëse të tij (të drejtat e tyre) dhe mban në këmbë vetëm partinë udhëheqëse. Partitë pjesëmarrëse konkurrojnë në zgjedhje, sikurse bën edhe partia udhëheqëse. Të drejtat dhe detyrimet e tyre nuk shuhen.

18.Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve nga partitë pjesëmarrëse tek partia udhëheqëse nuk vjen për shkak të fjalisë së dytë të paragrafit 3 të nenit 65, nuk vjen ipso lege, por vjen për shkak të fjalisë së tretë të tij, e cila përcakton se “marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ”. Është marrëveshja e koalicionit ajo që bën transferimin e të drejtave dhe detyrimeve tek partia udhëheqëse. Për këtë shkak, marrëveshja e koalicionit duhet të formojë jo vetëm autorizimin për partinë udhëheqëse të koalicionit për përfaqësim, por duhet edhe të vendosë modalitetet, procedurat dhe kufijtë e këtij përfaqësimi, duhet të vendosë përgjegjësitë dhe detyrimet e partisë udhëheqëse ndaj partive pjesëmarrëse në koalicion. Vetëm mbi këtë bazë mund të kryhet ushtrimi “në emër dhe për llogari” i të drejtave dhe përmbushja “në emër dhe për llogari” e detyrimeve nga ana e partisë udhëheqëse të koalicionit.

19.Fjalja e dytë dhe fjalja e tretë e paragrafit 3, të nenit 65 janë të pandashme dhe në unitet me njera tjetrën. Është ky unitet që bën të mundur që të drejtat dhe detyrimet e partive pjesëmarrëse në koalicion të mos shuhen. Ato mund të transferohen tek partia udhëheqëse e koalicionit, por që ky transferim të jetë detyrues për KQZ-në, ai duhet të jetë i shprehur qartë dhe pa ekuivoke në marrëveshjen e koalicionit.

29.Subjektet zgjedhore Partia Socialiste, Partia Demokratike, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit, Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, Nisma Thurje, Bindja Demokratike, Partia Socialdemokrate dhe Balli Kombëtar rezulton e provuar se kanë pasur mungesa në raportimin e kandidatëve të tyre, të cilat shkojnë, sipas rastit, nga 1 (një), deri në 153

(njëqind e pesëdhjetë e tre) kandidatë. Komisioneri ka kërkuar për këto parti vendosjen e sanksionit. KAS-i çmon se kërkesa e Komisionerit duhet të pranohet dhe sanksioni të mbahet për të gjitha subjektet në minimumin ligjor (pa proporcionalizuar masën), për të priorizuar qëllimin edukativ të masave administrative në këtë rast”.

GJYQTARE
MARSELA DERVISHI

GJYQTARE
BLERONA HASA